



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201400967/8

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda :** *Rekomandohet marrja e masave për mundësimin e privatizimit të objektit (banesës) në favor të shtetases F.T.*

**Drejtuar :** **Enno Bozdo**  
Nënkryetar i Bashkisë,

**TIRANE**

I nderuar z.Nënkryetar!

Prej Muajit Maj 2014, Institucioni që unë përfaqësoj ka në process shqyrtimi ankesën e shtetases F.T., në të cilën është prezantuar sheqetësimi për moszhvillimin e procedurave të privatizimit mbi objektin që ajo ka në posedim, ndodhur në Rrugën "Ali Demi", Pallati nr.2, Shkalla 3, Tiranë.

Për rastin në fjalë, është kërkuar me shkresën nr.K3/F15-2 Prot, datë 09.06.2014, organeve në varësin tuaj, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, informacion për procedurat e mundshme të kryera për privatizimin e objektit në favor të shtetases F.T. Në përgjigje të informacionit të kërkuar, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, pranë Bashkisë, Tiranë, me shkresën nr. 8742/5 prot, date 07.08.2014, bënë të ditur se ;

*"Me vendim të Këshillit Bashkiak nr.29, date 29.09.2008, është miratuar si Njësi Përgjegjëse Privatizimi për ndjekjen e procedurave të privatizimit të banesave, Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, të cilës ju jemi drejtuar me shkresë zyrtare për zj.F.T."*

Referuar akteve të vënë në dispozicion prej Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, pranë Bashkisë, Tiranë, si dhe shtetases Fatime Tahiraj, rezulton se, Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, me shkresat nr.647/1 prot, datë 07.07.2014 dhe Relacionin nr.995 Prot, datë 14.10.2014, drejtuar respektivisht z.Taulan Zeneli, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, si dhe zj.Dhurata Çipi, Drejtoresh Juridike, ka bërë të ditur se vijimi i procedurës për privatizimin e objektit do të mund të vazhdoj prej këtij organi, me rastin

e miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak, Tiranë, të fillimit të procedurave të privatizimit mbi objektin që posedohet prej shtetases F.T.

Ndodhur në situatën si më sipër prezantuar, marrja e masave të menjëhershme për mundësimin e zhvillimit të procedurave të privatizimit mbi objektin e ndodhur në Rrugën “Ali Demi”, Pallati nr.2, Shkalla 3, Tiranë, përveçse ka përbërë dhe përbën një detyrim të parashikuar në aktet ligjore në fuqi, do të jetë tregues i kujdesit të organit që ju përfaqësoni në marrëdhënie me qytetarin.

Në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

### **REKOMANDOJMË**

*Marrjen e masave të menjëhershme për dërgimin pranë Këshillit Bashkiak, Tiranë, të akteve të cilat mundësojnë miratimin e fillimit të procedurave për privatizimin e objektit (banesës) të ndodhur në Rrugën “Ali Demi”, Pallati nr.2, Shkalla 3, Tiranë, në favor të shtetases F.T.*

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.*

*Bashkëlidhur ju dërgojmë;*

*Kopje të shkresës nr.647/1 prot, datë 07.07.2014, të Drejtorisë nr.3 të Punëtorëve të Qytetit drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, pranë Bashkisë, Tiranë.*

*Kopje të shkresës (Relacionit) nr.995 Prot, datë 14.10.2014, të Drejtorisë nr.3 të Punëtorëve të Qytetit drejtuar Drejtorisë Juridike, pranë Bashkisë, Tiranë.*

**KOMISIONERI**

**Etilda GJONAJ(SALIU)**